



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

Nr. 1472 / prot.
4

Tiranë, më 19.4.2022

URDHËR

Nr. 516, datë 19.4.2022

PËR

**MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT TË MINISTRISË SË
MBROJTJES 2022-2025 DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT 2022-2023**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; të pikës 5, të nenit 16, të ligjit 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të shkronjës “F”, të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”; Vendimit nr. 516, datë 01.07.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 247, datë 20.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Ndër sektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020 dhe miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndër sektoriale Kundër Korrupsionit 2020-2023 e të Pasaportës së Indikatorëve”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Planit të Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes 2022-2025 dhe të Planit të Veprimit 2022-2023”, bashkëlidhur dhe pjesë e pandarë e këtij urdhri.
2. Drejtoritë e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura ngarkohen për zbatimin e Planit të Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes 2022-2025 dhe të Planit të Veprimit 2022-2023, sipas përcaktimeve në të.
3. Drejtorja e Monitorimit dhe Jetësimit të Prioriteteve në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Mbrojtjes në Ministrinë e Mbrojtjes, ngarkohet për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes 2022-2025 dhe të Planit të Veprimit 2022-2023, si dhe paraqet para ministrit të Mbrojtjes një raport vjetor mbi zbatimin e tij.
4. Drejtori i Drejtorisë së Monitorimit dhe Jetësimit të Prioriteteve në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Mbrojtjes, në Ministrinë e Mbrojtjes caktohet koordinator i Integritetit.

5. Strukturat përgjegjëse vartëse në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, ngarkohen për hartimin e Planeve të tyre të Integritetit brenda vitit 2023, sipas planifikimit në Planin e Veprimit 2022-2023.
6. Përgjigjen për zbatimin e këtij urdhri: Drejtoritë e Ministrisë së Mbrojtjes dhe strukturat përgjegjëse vartëse, si dhe Shtabi i Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe strukturat përgjegjëse vartëse të tij.
7. Ndjekin zbatimin e këtij urdhri zëvendës Ministri i Mbrojtjes dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

